



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 11.08.2017

Ref.: 692/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa nr.547/17, datë 14.07.2017 e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Prishtinë për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr.562/17, datë 06.07.2017.
- II. Hiqet masa e pezullimit të akreditimit sipas vendimit nr. 562/17, datë 06.07.2017 për programin e studimit:
 - Gjeodezi, BSc, 180 ECTS.
- III. Lejohet regjistrimi i studenteve në programin e cekura në pikën dy të këtij vendimi.
- IV. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së nr.562/17, datë 06.07.2017 mbetet e pa ndryshuar.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës me 14.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 562/17, datë 06.07.2017, me të cilin vendim Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës i është pezulluar akreditimi për dy programe të studimit: Gjeodezi, BSc, 180 ECTS, dhe Gjeodezi, MSc, 120 ECTS.


Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës, është konstatuar që programi i studimit Gjeodezi, BSc, 180 ECTS, i plotëson kushtet sa i përket stafit akademik që parashihen me Udhëzimin Administrativ për Akreditim nr.20/2016,

datë 20.09.2016, nenit 11, pika 3.2. Bazuar në dispozitat e cekura me lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

